

Gjon BERISHA

LOJËRAT DHE ARGËTIMET MESJETARE NË KOSOVË

Abstrakt:

Artikulli trajton disa aspekte të lojërave dhe të argëttimeve mesjetare, të cilat ishin pjesë e rëndësishme e jetës së përditshme e shoqërisë në Kosovë. Koha e trajtimit është një periudhë kur disa prej qyteteve të Kosovës të dalluara për zhvillimin e minierave, të zejtarisë dhe të tregtisë ishin të lidhura ngushtë me tregtarët dhe profesionistë tjerë të huaj, kryesisht nga bregdeti i Adriatikut. Si rezultat, një pjesë e konsiderueshme e të dhënave për këto aktivitete, vijnë nga fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut. Nga këto burime dhe informacione tjera, rezulton se pavarësisht nga sfidat e përditshme dhe kushtet shpesh të rënda, njerëzit gjenin mënyra për t'u argëtuar dhe për të festuar, qofshin të pasur apo të varfër. Lojërat dhe aktivitete argëtuese në Kosovën mesjetare ishin të shumëllojshme, por ne do t'i trajtojmë vetëm ato që lanë gjurmë në burimet e shkruara, të cilat, për fat të keq, janë mjaft të pakta. Llojet e lojërave dhe argëttimeve variojnë nga turnetë kalorësiake të dëshmuara në Prishtinë apo ato të gjuajtjes me hark dhe shigjetë në Novobërdë e deri të festat e kalendarit kishtar, lojërat popullore, aktrimet, karnavalet, muzika dhe ushqimet tradicionale. Për shkrimin e këtij artikulli janë shfrytëzuar burime të ndryshme dhe literaturë relevante, por fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut, sidomos ato gjyqësore, për shkak të vlerave të veçanta që bartin janë përdorur gjerësisht.

Fjalë kyçe: *Lojërat mesjetare, argëtimet, kalorësia, panaiet, Prishtina, Novobërda.*

Trajtimi i historisë sociale në shumicën e rasteve mbizotërohet nga fokusi i studiuesve në drejtim të historisë politike, të sundimtarëve, të personaliteteve të shquar. Kjo ka bërë që të lihen anash ngjarje nga jeta e përditshme siç janë aktivitetet garuese e rekreative. Në këtë mes, gjithsesi hyjnë dhe lojërat, argëtimet dhe garat popullore apo aktivitetet sportive me rastin e festave të caktuara apo panairëve. Nga këto më të njohura mund të konsideroheshin kalërimi, gjuajtja me armë, garat e mundjes, muzika e vallëzimi, aktrimi apo aktivitete tjera luftarake, për të cilën janë ruajtur të dhëna më të shumta. Edhe pse këto aktivitete ishin pjesë e përditshmërisë së shoqërisë mesjetare, historia e lojërave dhe argëtimit në qytetet e Kosovës, përgjithësisht, nuk ka gjetur ndonjë trajtim të veçantë, apo në rastin më të mirë është trajtuar në margjina të ngjarjeve politike apo ekonomike. Andaj, disa të dhëna që po sjellim në këtë studim janë vetëm një hap fillestar drejt mundësive për t'u zgjeruar në kërkime më të detajuara në këtë drejtim.

Lojërat sportive të zhvilluara gjatë antikitetit ishin një faktor i rëndësishëm që ndikoi në të gjithë jetën shoqërore. Gjatë ngjarjeve më të mëdha sportive, Lojërave Olimpikë, të gjitha armiqtë, madje edhe konfliktet e luftës, pushonin dhe fituesit konsideroheshin të barabartë me perënditë. Ndonëse u zhvillua mbi themelet e kulturës greke dhe organizimit shtetëror romak, mesjeta, nën ndikimin e krishterimit, ndaloi Lojërat Olimpikë, duke i konsideruar ato si relike pagane apo të rrezikshme, kështu që shumica e sporteve u bënë të padëshirueshme. Në këtë kontribuan edhe pushtimet barbare që shkatërruan mbetjet e shoqërisë së vjetër.¹ Veçanërisht të dëmshme konsideroheshin ato lojëra që zhvilloheshin me ndihmën e armëve, të cilat rrezikonin jetën e njerëzve. Në përputhje me një botëkuptim të tillë, në vitin 393, perandori bizantin Theodosius I shfuqizoi mbajtjen e Lojërave Olimpikë në Perandori. Megjithatë, tradita e lashtë ishte ende e fortë, kështu që lojërat vazhduan, natyrisht me intensitet shumë më të ulët.

¹ Robert Hannah, "Ancient Greek Calendars", *Handbook of Archaeoastronomy and Ethnoastronomy*, C. N. Ruggles (ed), (New York: Springer, 2014), 1565-1566; Paul Christesen, *Olympic Victor Lists and Ancient Greek History*, (Cambridge: Cambridge University Press, 2007), 15-21.

Megjithatë, jo të gjitha lojërat ishin në të njëjtin pozicion: ligji i kishës lejonte: mundjen, vrapimin, kërcimin dhe hedhjen diskut.²

Kalorësia është një fenomen kulturor dhe ushtarak me origjinë mesjetare. Në shoqërinë feudale mesjetare, në kohë paqeje, kalorësit ishin të angazhuar kryesisht në gjueti dhe në gara shkathtësie. Mendohet se rregullat e para të shkruara për turnetë e kalërimit u përpiluan nga kalorësi francez *Geoffroy de Preuilly* në shek. XI, por që pësoi ndryshime të thella në fund të Mesjetës.³ Pasiguria e përgjithshme e asaj kohe dhe përleshjet e shpeshta lokale kontribuan në zhvillimin e këtyre llojeve të garave të financuara nga fisnikëria. Nëpërmjet martesave dhe lidhjeve të tjera, lojërat dhe garat kalorësiake u përhapën në të gjithë Evropën feudale.⁴ Kështu, lojëra të tilla u organizuan edhe në qytetet mesjetare të Kosovës, në të cilat merrnin pjesë fisnikëria, qytetarët, tregtarët dhe në periudhën e mëvonshme edhe fshatarë të lirë. Kosova, e cila gjendej nën sundimin e Bizantit, por edhe nën ndikimin kulturor të Evropës Perëndimore, përveç lojërave tradicionale vendase, u ekspozua edhe ndaj ndikimeve nga lindja dhe nga perëndimi.

Këto ndikime janë të pranishme edhe në fushën e lojërave të kalorësisë. Ndikimet lindore erdhën nga qytetet bizantine dhe ato perëndimore nëpërmjet qytetarëve të huaj që jetonin dhe punonin në Kosovë: minatorët (saksonët), tregtarët dhe artizanët nga Bregdeti Adriatik (bregdeti shqiptar, Raguza, Kotorri dhe qytetet italiane), si dhe njësitë ushtarake të angazhuar nga sundimtarë të ndryshëm. Aktivitetet sportive, lojërat dhe garat e kalorësisë në qytetet e Kosovës mesjetare janë të lidhura me ngjarje të ndryshme shoqërore dhe gjenden në mjedise të caktuara, siç janë vendbanimet urbane, qendrat xeherore, tregjet, si dhe në tubime në ambiente të caktuara kishtarë me rastin e panairove dhe festave fetare. Aktivitetet sportive ishin të natyrës konkurruese apo me qëllim argëtimin e audiencës.

² David C. Young, *A brief history of the Olympic games*, (Oxford: Blackwell Publishing, 2004), 136-137; Božidar Zarković, "Sport, igre i viteštvo u srednjovekovnoj Srbiji", *Physical education and sport through the centuries*, vol.IX, br.1 (Niš, 2022), 102-103.

³ Paul-Alexandre Savette, *Tournois et Carrousels*, (Saumur: A. Roland Impression, 1937), 10.

⁴ Nikola Kuretić, "Igra konjanika u Prištini 1435", *Povijest sporta*, br.15 (Zagreb, 1973), 217.

Prania e tyre në Kosovë gjatë mesjetës është e padiskutueshme, por burimet e kufizuara historike nuk lejojnë që kjo pamje e jetës shoqërore të shihet qartë. Megjithatë, të dhënat e pakta që kemi në dispozicion e që flasin për Kosovën, do të mundohemi t'i krahasojmë me lojërat e përafërta apo të njëjta që u zhvilluan në vendet fqinjëve, sidomos ato të qyteteve të bregdetit dalmat.

Përgjithësisht, garat zhvilloheshin në një hapësirë të lirë, në hipodrome.⁵ Burimet e kohës më së shpeshti përmendin garat e shpejtësisë: garat me kuaj dhe ato të vrapimi. Në Kosovë, nuk kemi njohuri për ekzistencën e një fushe të tillë sportive (hipodromi), por dihet se në periferi të Prishtinës, si dhe në Novobërdë, ka pasur një hapësirë ku zhvilloheshin gara të tilla.⁶ Prishtina dhe Novobërda ishin dy qytetet më të mëdha të Kosovës në gjysmën e dytë të shekullit XIV dhe gjysmën e parë të shekullit XV, i pari i njohur si qytet tregtar, kurse i dyti si qytet xehetar.

Një nga lojërat e preferuara të kalërimit në qendrat urbane të Kosovës dhe më gjerë ishin ato me shtiza që gjuanin në caqe të caktuara, të quajtura “*giostre*” në Itali, “*alka*” (heqja e hallkës, unazave) në Dalmaci dhe ajo e “*dorezave*” në Prishtinë. Këto lojëra zhvilloheshin nga sa vijon: garuesit vraponin nga njëri skaj i fushës me kalë, me një shtizë të gjatë në duar. Në anën tjetër të fushës, në një shtyllë druri, varej një unazë (hallkë), ose dorezë që konkurrentët duhej ta hiqnin me shpejtësi të plotë. Për “Alkën”, e cila praktikohesh në Dalmaci, në qytetin e Zarës, Sinjit, Raguzës e Zagrebit, e cila organizohej për festën e pajtorit të qytetit, Shën Vlashit (në Raguzë), dihet në bazë të vendimeve të Këshillave të Raguzës dhe përshkrimit të dëshmitarit okularë, shkrimtarit dhe rektorit të shkollës së Raguzës, *Philippus de Diversis de Quartigianis* (1440).⁷ Diversis, në librin e tij “Përshkrimi i qytetit të famshëm të Raguzës” thotë se alka ishte një lojë ku të rinjtë meshkuj

⁵ Franc Miklosich, *Lexicon paleoslovenico-graecolatinum*, (Vindobonae: Guilelmus Braumu, 1862-1865), 644.

⁶ Božidar Zarković, D. Gašić, “Viteške igre u srednjovekovnoj Srbiji - poreklo, karakter i značaj”, *Zbornik radova 7. Međunarodna konferencija “Antropološki i teoantropološki pogled na fizičke aktivnosti od Konstantina Velikog do današnjih dana”*, (Kopaonik, 2020), 259; B. Zarković, “Sport, igre i viteštvo u srednjovekovnoj Srbiji”, 108.

⁷ Milivoj Petković, “Alka u starom Dubrovniku”, *Dubrovački vjesnik*, br. 357 (Dubrovnik, 1957), 5; Zdravko Šundrica, *Tajna kutija Dubrovačkog Arhiva*, II (Zagreb-Dubrovnik: HAZU- Zavod za Povijesne Znanosti u Dubrovniku, 2009), 279.

vendosnin një hallkë (unazë, rreth) argjendi me peshë prej 4 unçë (1 oz = 28.35 gram), vraponin mbi kuaj me shtizë dhe ai që e kapte hallkën me shtizë tri herë gjatë garës, e fitonte garën.⁸

Burimet historike theksojnë se një lojë e tillë me kuaj është praktikuar edhe në Prishtinë dhe se ky aktivitet konkurrues u zhvillua në një fushë të quajtur *Poteçishte*, që në fakt është term arkaik për hipodrome. Këto gara janë organizuar çdo vit të ngjashme me hallkën - vetëm me një dallim: në vend të hallkës është përdorur doreza, të cilën kalorësit e kanë pasur për detyrë ta qëllonjë me shpatë, shtizë ose topuz. Dëshmitë dokumentare konkrete për lojën e kalërimit në Prishtinë, të zhvilluar në prag të Krishtlindjes së vitit 1435, na vijnë falë dokumenteve nga Arkivi Shtetëror i Dubrovnikut në serinë “Lamenta de foris” - dokumente gjyqësore për vitin 1436. Dokumenti në fjalë është bërë i njohur për herë të parë në një botim përmbledhës në gjermanisht “*Archiv für slavische Philologie*” nga K. Jireček, në vitin 1892 dhe një shtesë në vitin 1893.

Këto të dhëna vijnë si pasojë e një konflikti mes konkurrentëve të cilët kishin nxjerrë edhe armët dhe pas lëndimeve që kishin pësuar, rasti kishte përfunduar në gjykatën e Raguzës. Dokumenti i shkruar në një dialekt të italishtes së vjetër, sjell përveç tjerash edhe të dhëna për qytetin e Prishtinës, tregun, dyqanet, shtëpitë, gjallërimin e jetës ekonomike, vendin e lojërave të kalorësisë me emrin *Potoçishte*.⁹ Kjo hapësirë e lojërave më vonë është e njohur në burime osmane të vitit 1477 edhe si lagje e veçantë (Mëhalla “*Poteçishte*” me 40 shtëpi) me të njëjtin emër.¹⁰ Sipas përshkrimit që K. Jirečekut i bënë dokumentit, loja e trajtuar në këtë rast u zhvillua në kohën e despotit Gjergj Brankoviqit, në Prishtinë në ditën e Krishtlindjes 1435, dhe

⁸ “*Aliquoties item juvenus mascula, posito circulo argenteo quatuor unciarum, in equis currit cum hastis, et qui anulum lancea ter sumpserit currens illum recipit, ...*”, Philippus de Diversis de Quartigianis, *Situs aedificiorum politiae et laudabilium consuetudinum inclytae civitatis Ragusij: codice inedito della biblioteca ginnasiale di Zara pubblicato da V. Brunelli*, (Zara:G. Woditzka, 1882), 95.

⁹ Constantin Jireček, “Reiterspiele im mittelalterlichen Serbien”, *Archiv für slavische Philologie*, band. 14 (Wien, 1892), 73-75; *I njëjti*, “Nachtrag zu den Reiterspielen im mittelalterlichen Serbien”, *Archiv für slavische Philologie*, band 15, (Wien, 1893) 457-458.

¹⁰ Adem Handžić, “Nekoliko vijesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV vijeka”, *Simpozium për Skënderbeun – Simpozijum o Skenderbegu (9-12 maj 1968)*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1969), 209.

ky ishte një aktivitet vjetor (*festum consuetum*), i cili festohej në një hapësirë lojërash në periferi të qytetit të rrethuar nga disa kasolle ndihmëse me çati prej kashte, të destinuara për gara. Kjo garë ishte zhvilluar “shumë herë”. Shprehje “*alquante volte*” përsëritet vazhdimisht nga të gjithë dëshmitarët dhe ky është një informacion shumë domethënës, sepse na tregon se nuk ishte thjesht një konkurrencë ad hoc (“... corsemo a poticiste *alquante volte*” ose ... corando *alquante volte*” ose ... “corsemo con le lanze *alquante volte*” etj.).¹¹

Vendi, në të cilin zhvilloheshin këto gara quhej hipodrom apo shesh lojërash. Gjithnjë sipas dokumentit në fjalë të interpretuar nga Jireček, kjo ishte një lloj gare ku kalorësi vraponte me një shtizë të gjatë dhe duhej të hiqte (ngrinte lart) një dorezë të vendosur në një shtyllë druri (*baston*).¹² Garuesit vinin me përgatitje komplete, me topuz ose bozdogan (*macia deferron*), një lloj thike të gjatë turke (simitar), shtizë dhe me hark e shigjetë, armë krejt të zakonshme për këto vende dhe kohën. Të dhënat burimore në dispozicion bëjnë fjalë për pjesëmarrjen e tregtarëve raguzanë, fisnikëve, qytetarëve dhe shërbëtorëve të tyre. Në këtë rast, si dëshmitar i këtyre aktiviteteve, përmendet edhe fisniku arbëror nga Ulqini (Stefan de Tani).¹³

Ndonëse dokumenti përmend specifikisht tregtarët raguzanë, të cilën kishin koloninë e tyre, megjithatë, nëse e kemi parasysh se hipodromi ku zhvilloheshin këto lojëra gjendej në Prishtinë, atëherë kuptohet vetvetiu se përveç tregtarëve nga Ragusa, qytetarët tjerë të zakonshëm, një pjesë e të cilëve ishin në shërbim të ndërmarrësve raguzanë ishin vendas, të cilët ndiqnin lojën dhe brohoritnin aktivisht për të preferuarit e tyre. Të gjitha detajet e kësaj loje interesante, e cila tregon për jetën shoqërore dhe aktivitetet kulturore të qytetarëve të Prishtinës, i mësojmë nga një proces gjyqësor lidhur me përleshjen që shpërtheu në mes pjesëmarrësve në këto lojëra. Të përfshirët në konflikt në fushën e kalërimit (hipodrom) ishin me nënshtetësi raguzane, ku, siç thotë dokumenti, tregtari raguzan Tasovaz Radmilich mori një goditje të fortë në hundë.¹⁴ Pretekst i konfliktit ishte bërë dorëza e lojës. Doreza që

¹¹ C. Jireček, “Reiterspiele im mittelalterlichen Serbien”, 73.

¹² “*gcorsemo alquante volte con le lanze al guanto, lo quel iera messor*”, C. Jireček, “Reiterspiele im mittelalterlichen Serbien”, 73-74.

¹³ *Po aty*, 75.

¹⁴ Desanka Kovačević-Kojić, “Priština u srednjem veku”, *Istorijski časopis*, br. XXII (Beograd, 1975), 65.

duhej goditur në garë, ishte vendosur më parë në një hu nga Ratcho Rexa (“Resa”) me profesion argjendar, i cili duhej të vraponte në drejtim të saj. Meqenëse lojën me atë dorezë e filloi një garues tjetër, Tosovaz Radmilovich, pasoi një përleshje. Sipas dëshmitarëve, atë ditë të pranishëm ishin djemtë (“famegli”) e Tasovazit, të cilët u sulmuan nga Ratcho. Si pasojë e kësaj përleshjeje, Ratcho Rexa e plagosi në fytyrë Radmilovich-in me një shtizë. Por, falë ndërhyrjes së pjesëmarrësve të tjerë, përleshja kishte përfunduar pa viktima. Për pasojë jeta e tij ishte në rrezik¹⁵

Rasti në fjalë kishte përfunduar në gjykatë. Dokumenti gjyqësor i 17 janarit 1436 i referohet procesit gjyqësor në lidhje me padinë e Tasovaz Radmilovich-it, i cili gjatë festave të Krishtlindjes (*die Natalis Domini, dum fieret frustum consuetem in Pristina per nobilis et mercatores*) së vitit 1435, në një përleshje në terrenin sportiv në Prishtinë, u plagos rënd nga Ratchus Rexa (“Resa”).¹⁶ Në këtë dokument gjyqësor të Republikës së Raguzës, i shkruar pjesërisht në latinisht dhe pjesërisht në zhargonin raguzan (dialekt italian shumë i përdorur në tregti dhe detari në atë kohë), përshkruhet padia, ftesa për të marrë në pyetje dëshmitarët në Prishtinë, deklaratat e dëshmitarëve dhe vendimi i gjykatës së Raguzës për dënimin e fajtorit. Meqenëse palët e konfliktuara ishin tregtarë, në mesin e të cilëve një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve të Raguzës nga kolonia e tyre tregtare në Prishtinë, sipas rregulloreve të kohës, gjykata e kësaj Republike ishte qartësisht kompetente për ta.

Në pjesën e dytë të këtij dokumenti lexojmë dëshmitë e dëshmitarëve prezentë në vendin e ngjarjes. Si dëshmitarë ndeshim *ser Zugno de Calich, ser Zugno de Gondola, Radman Pribilouich, ser Marin Piero de Lucari* dhe fisnikun ulqinak me origjinë arbërore *Stephano di Tani*.¹⁷

¹⁵ “...Ratcho Resa feri Tasouaz Radmilouich”, C. Jireček, “Reiterspiele im mittelalterlichen Serbien”, 74.

¹⁶ “Fazando festa di Natal proximo secondo vsanza deli mercadanti caualchassismo a potizissta, esiando a potizista ta corsemo alquante volte con le lanze al guanto, lo qual icra messo. Dapoi partissemo alquanti di noi. E siando da largo da una casa pagliara, che ierano apresso potiçiste, e con mi jera Radossauo Vocmirich detto Salamon, loqual Radossauo se volto e cominzo a cridare piu volte: non demo, che se faze care”! “E vitti molte, e Radossauo detto aueua tratta la simitara soa ...”, C. Jireček, “Reiterspiele im mittelalterlichen Serbien”, 74-75.

¹⁷ *Po aty*, 74-75.

Të dhënat e dokumentit të 17 janarit 1436 mbi lojërat kalorësiake në Prishtinë rikonfirmohen edhe nga një pjesë tjetër e padisë e regjistruar në të njëjtin libër gjyqësor më 27 mars 1436. Padia në fjalë është regjistruar në sllavisht (*in lingua sclaua*) nga kancelari i Raguzës, *Nicola de Stella* dhe i përkthyer në latinisht, përkatësisht në italishte të vjetër.¹⁸

Dokumentet e përmendura, veçanërisht deklaratat e një numri të madh dëshmitarësh të dhënë nën betim gjyqësor, menjëherë pas konfliktit (Krishtlindje 1435 - 20 janar 1436), janë të mbushura me të dhëna autentike me rëndësi të madhe për historinë e lojës së kalorësisë mesjetare, veçanërisht të lojërave të kuajve me karakter sportiv, të aplikuara në atë kohë në Kosovë dhe më gjerë.

Për nga përmbajtja, loja kishte karakteristikat e një ushtrimi ushtarak ku praktikohesh dhe demonstrohesh shkathtësia e qëndrimit në shalë dhe e mbajtjes në dorë të një shtize të gjatë. Sipas origjinës dhe qëllimit të tij, ky lloj argëtimi nënkuptonte posedimin e një kali luftarak dhe të pajisjeve ushtarake nga garuesit. Ndonjëherë dikush mund të huazonte një kalë dhe shtizë nga një mik, siç bëri Radmilovich nga shoku i tij Vicko (*...e tolse da Vitko suo compagno la simitara e lo cavallo e corse una volta al guanto*). Kjo lloj loje konkurruese kërkonte një hapësirë të hapur dhe të gjerë dhe nuk është rastësi që hipodromi i Prishtinës ishte në periferi të qytetit.

Me këtë rast, me shumë rëndësi është përmendja e familjeve shqiptare, sidomos atyre: Tani, Arbanasi, Spani, Lucari, Gondola etj., një pjesë e të cilëve ishin nënshtetas raguzanë. Në mesin e këtyre, vend të veçantë zë familja fisnike ulqinake Tani. Këta ishin Mako de Tani (1414-1426) me të bijtë Marinin (1425, pastaj nga 1433-1448), Stefanin, i cili ishte edhe dëshmitarë i rastit të lojërave kalorësiake (1435-1436, 1442, 1446-1447) dhe Junin (1445). Nga kjo familje, figura më e njohur ishte vëllai i katërt Kimo

¹⁸ “o Radcho ouer io ancho perdera lo cauo . [...] E siando in campo a corer cauali, quel Tassouaz cum li seguaci trassi la spada soura mio cosino Radoano per amazarlo. [...] feriti me lo caualo per lo cauo e talioli la horegia. [...] E sopra tuto lo dito Tassoaz scrisse lamento sopra de nuy alo grando zudese del signor dispoto et a Oliuer chetalia de Pristina, digando che piu el non e Raguseo, saluo homo del signor dispoto, e lo zudesse scrisse ali merchadanti in Pristina, che Tassoaz o homo del signor dispoto e mando sua famelia e robo mi la casa e ligo me, et li merchadanti me feceno plegiaria”, C. Jireček, “Nachtrag zu den Reiterspielen im mittelalterlichen Serbien”, 457.

Tani, i cili kaloi në Prishtinë 14 vjet dhe gjatë kësaj kohe u zgjodh 130 herë në komisione gjyqësore. Familja Tani, përmendet përsëri në brezin e tretë (1424) me Radojen, nipin e Makos dhe djalin e Marin de Tanit. Në një letër drejtuar Kim Maka de Tanit, qeveria raguzane e quante shprehimisht “qytetarin tonë të respektuar”.¹⁹

Të dhënat fragmentare që sjellin dokumentet mbi lojërat garuese të kalorësisë në Prishtinë, na japin të kuptojmë me siguri se gara të tilla ose të ngjashme janë mbajtur shumë kohë më parë, gjë që konfirmohet nga deklaratat e bëra se ky ishte një zakon (*festum consuetum in Pristina*), domethënë një traditë, dhe kjo tregohet nga një vendi i përhershëm i grumbullimi, që pa dyshim nuk ishte menduar vetëm për këtë garë, ku kishte ndodhur përleshja në fund të dhjetorit 1435. Mund të konsiderojmë gjithashtu se gara të ngjashme janë zhvilluar edhe në qendra të tjera të rëndësishme minerare e tregtare.


Nga qendrat urbane të Kosovës mesjetare, për pasuritë e saj minerare dhe zhvillimin e aktiviteteve të shumta shoqërore, dallohej Novobërda. Edhe në rastin e Novobërdës, burimet bazë prej të cilave informohemi për festimet dhe format e veçanta të lojërave garuese apo argëtuese, vijnë nga materiali dokumentar i Raguzës. Falë këtij materiali u ruajtën dëshmi të praktikës së lojërave të gjuajtjes me hark dhe shigjetë në një poligon në periferi të Novobërdës.²⁰ Edhe kësaj radhe, informata vjen si pasojë e një konflikti që kishte shpërthyer në mes banorëve në Novobërdë më 26 janar 1413 gjatë ushtrimeve gjuajtjes me shigjetë në afërsi të qytetit. Me këtë rast, në dokument, thuhet se dy qytetarë të dëmtuar kishin paditur tre të tjerë me arsyen se derisa po largoheshin nga periferia e qytetit ku kishin luajtur me hark dhe shigjeta (*pro ludendo ad arcum et balistam*), njëri nga këta, Martini ishte sulmuar dhe goditur tri herë me thikë. Qytetari i dëmtuar i Novobërdës, Nikollë Saraku, nga ana e tij, kishte ngritur një padi kundër Sinkos përmes vëllait të tij Gjonit: derisa Nikolla ishte duke luajtur me shokët e tij me hark dhe shigjetë, në periferi të qytetit një qytetar tjetër, i quajtur Sinko ua kishte vjedhur harkun dhe shigjetën.²¹

¹⁹ D. Kovačević-Kojić, “Priština u srednjem veku”, 67-68.

²⁰ Mihailo Dinić, *Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni*, II, (Beograd: SANU, 1962), 47, shën. 5.

²¹ “*varosi pro ludendo ad balistam secundum consuetudinem cum aliis sociis..*”, HR-DADU,

Njohja e përdorimit të harkut dhe shigjetës në kohë paqeje si mjete argëtimi me sa duket u kishte shërbyer pozitivisht edhe në rastin kur kërkohej mbrojtja e qytetit nga rreziku osman. Në gushtin e vitit 1425, derisa sulltan Murati II, po kërcënonte Novobërdën, qytetarët iu përgjigjën pozitivisht thirrjes për mbrojtjen e qytetit. Sipas kësaj thirrjeje, çdo qytetar i këtushëm duhej të armatosej dhe të merrte me vete një hark dhe pesëdhjetë shigjeta.²²



Tregtarët raguzanë në Novobërdë urdhërohen të mbanin me vete një hark dhe shigjeta.

Për dallim nga burimet letrare, të dhënat e ndryshme të Arkivave të Raguzës portretizojnë rolin e vërtetë të qytetarëve në raport me lojërat dhe argëtimet e tyre. Kështu, përveç dokumenteve zyrtare të Republikës së Raguzës, siç janë vendimet e Këshillit të Vogël që kanë të bëjnë me Kosovën në shek. XV, njoftime gjenden edhe në dokumente të natyrës private, siç është libri i debitorëve të afaristit Mihail Lukarit nga Ragusa, i cili jetonte dhe punonte në Novobërdë. Në mesin e emrave të shumë profesioneve, në këtë libër përmenden edhe emra të lojtarëve, aktorëve dhe muzikantëve vendas si palë në procedura gjyqësore, zakonisht si dëshmitarë e të pandehur gjatë mosmarrëveshjeve të ndryshme, apo si borxhlinj në listat e debitorëve të sipërmarrësve të pasur të Raguzës në qendrat tregtare mesjetare të Kosovës.²³

Ndonëse në mënyrë fragmentare, nga këto burime, kryesisht me origjinë nga Ragusa, mësojmë për njerëzit që merreshin me argëtimin e tregtarëve dhe qytetarëve tjerë të quajtur aktorë (në dokumente të Raguzës,

Litterae et commissiones Levantis, vol. VII (1411-1416), fol.63^r-63^v; M. Dinić, *Za istoriju rudarstva*, II, 47.

²² “*Capum fuit quod quia dominos despotus fecit preceptum mercatoribus Ragusinis existentibus in Nouaberda, quod retinere debeant penes se unam balestram*”, HR-DADU, *Acta Consilii Minoris*, vol.III (1422-1426), fol.252^r.

²³ *Dubrovačko malo veće o Srbiji: 1415-1460*, sabrao i priredio A. Veselinović, (Beograd, Istorijski institut SANU), Beograd 1997; Mihailo Dinić, “Knjiga Mihaila Lukarevićem”, *Iz Dubrovačkog Arhiva*, knjiga I, Beograd, 1957.

quheshin *glumaz*), si dhe për praninë e tyre në vende të caktuara në Kosovë. Aktorë të tillë shëtitës përmendën në vitin 1425 në Novobërdë.²⁴

Lëvizshmëria e aktorëve të tillë mund të interpretohet jo vetëm nga orientimi i tyre drejt qendrave më të mëdha urbane, por edhe nga kontaktet që ata kishin vendosur ndërmjet këtyre qendrave ekonomike. Përmbajtja e librave të borxheve të tregtarit raguzan, Mihail Lukarit, na njofton edhe me aktorë që erdhën me origjinë nga rajone të ndryshme, por që qëndruan disa kohë në Novobërdë. Kështu, në vitin 1438, tre aktorë u regjistruan si debitorë të M. Lukarit: aktori *Vuchoie Iuanchouich* nga Livaçi (de Liuada) dhe *Milosau nga Brezovica* (de Brixouiza), ka shumë të ngjarë të kenë ardhur nga vendet e përmendura, të cilat ndodheshin në rrethinat më të gjera të qytetit të Novobërdës.²⁵

Një grup të veçantë përbënin aktorët dhe trupat argëtuese, të cilët performonin në sheshe publike dhe oborre të feudalëve të mëdhenj e të vegjël duke i argëtuar të pranishmit me komedi, drama dhe shfaqje tjera. Këtyre, Evropa latine u vendosi emrin *minstrel* (nga lat.: *ministerium*, “shërbyes”).²⁶

Lajmet më të shumta për aktorët e oborrit dhe muzikantët vijnë nga shekujt XIV dhe XV. Këto të dhëna na tregojnë për shkëmbimin e ndërsjellë të argëtuesve dhe të grupeve të tyre në oborret e fisnikërisë. Në kuadër të marrëdhënieve dhe të komunikimit të botës së fisnikërisë, shkëmbimi i muzikantëve dhe i aktorëve ishte i rëndësishëm për forcimin e miqësisë dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore. Përsëri, shumica e të dhënave të

²⁴ “7 jul 1425 in Novaberda...contra Radivoy glumaz et Milaç”, *Dubrovačko malo veće o Srbiji*, 155; Desanka Kovačević-Kojić, “Prilog proučavanju zanatstva u Novom Brdu i okolini”, *Zbornik Filozofskog fakulteta*, VIII-2 (Beograd, 1964), 525-532.

²⁵ “*Vuchoie Iuanchouich glumaz de Liuada... Milosau glumaz de Brixouiza...*”, M. Dinić, “Knjiga Mihaila Lukarevićem”, 81, 86. Nëse i referohemi periudhës, pak më të vonshme, kur bëhet fjalë për vendndodhjen e fshatrave Livaçe (Livad) dhe Brezovicë, sipas regjistrimit osman të vitit 1455, ato ndodheshin në një distancë prej 30 apo më shumë kilometër nga Novobërda. Fshati Livada ndodhej në vilajetin e Prishtinës, kurse Brezovica (Brezoviça) në nahijen e Llapit (*Oblast Brankovića: opširni katastarski popis iz 1455. Godine*, Hamid Hadžibegić, Adem Handžić, Ešref Kovačević (Serija II, Defteri; Knj. 2, sv.1-2), Sarajevo: Orijentalni Institut, 1972, 217, 327).

²⁶ John Southworth, *The English Medieval Minstrel*, (Woodbridge, Suffolk: The Boydell Press, 1989), 3-4; “Minstrel”, *Encyclopædia Britannica*. Vol. 18 (11th ed.), (Cambridge University Press, 1911), 557.

ruajtura janë me origjinë nga Raguza dhe i referohen kryesisht raporteve të kësaj Republike me fisnikërinë e lartë të vendeve fqinje. Burim bazë janë vendimet e këshillave të Raguzës, të cilat kryesisht përmbajnë informacion të shkurtër dhe konciz për trupat e aktrimit, punëdhënësit e tyre dhe aktivitetet e artistëve.

Grupet argëtuesve ishin të ndryshme. Ato përbëheshin nga aktorë (“buffones, hystriones, ioculatores”), lahutarë (“lautarius, pulsatores”), performues të instrumenteve frymore (“piffari, tubetae, tubicinae, sonatores”) dhe baterist (“gnacharini”). Shpesh të gjithë së bashku formonin një shoqëri. Nga këto, muzika dhe vallëzimi ishin një formë e rëndësishme e argëtimit. Në festa të ndryshme, si dasmat, lindjet e fëmijëve ose ngjarjet fetare, njerëzit vallëzonin nën shoqërinë e muzikantëve që luanin me instrumente.


Këto ngjarje shërbenin jo vetëm si formë argëtimi, por edhe si mundësi për të forcuar marrëdhëniet shoqërore dhe fqinjësore. Në të mirë të raporteve fqinjësore, Raguza dërgonte muzikantë dhe aktorë në sheshet dhe oborret e fisnikërisë fqinje (ose anasjelltas) për raste të ndryshme, qofshin ato festa kalendarike apo familjare. Kështu, më 5 dhjetor 1385, Komuna e Raguzës dërgoi muzikantë dhe aktorë (*tubatores et iocularios nostros domino Georgio Balsa*) te zoti i Zetës, Gjergj II Strazimir Balsha.²⁷

Në shtator të vitit 1395, nga Raguza u dërguan muzikantë për të kremtuar festën e Shën Marisë (8 shtator) në abacinë e Rotacit,²⁸ pranë Tivarit në Zetë, nën zotërimin e Balshajve. Në shkurt 1412, për festën e Shën Vlashit (*venerunt ad honorandum festum Sancti Blaxii*), gjashtë trumbetist të Balshës performuan në Raguzë. Me atë rast Këshilli i Raguzës u dha secilit nga 10 dukatë. Ndërsa në korrik 1415 sundimtari i Zetës, Balsha III (1403-1421), festoi lindjen e djalit të tij, Këshilli i Raguzës i lejojë artistët e tij që të qëndrojnë në oborrin e Balshajve për t’i argëtuar për tetë ditë “... *fuit de dando*

²⁷ Mihailo Dinić, *Odluke veća Dubrovačke Republike [Acta Consiliorum Reipublicae Ragusinae]*, vol. II, (Beograd: SANU), 1964, 146.

²⁸ “...*ad sonum campane more solito congregato facta fuit gracia piffaris nostris Ragusii salariatis eundi ad festum s.Maria Reteçii durando salarium*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXX (1395-1397), fol.19v; “... *sarebbero andati alla fiera di Rotez anche i Ragusei e i musici...*”, Giuseppe Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balsidi: studi storici documentati*, Spalato: Tip. Sociale Spalatina G. Lagh, 1899, 181.

*licentiam piffaris et tubatoribus quod possint ire pro dies octo ad dominum Balsam pro gratulatione filii sibi nati...*²⁹



Pjesëmarrja e trupës argëtuese nga Raguzë në oborrin e Balshajve (10 korrik 1415).

Një vend i rëndësishëm argëtimi ishin edhe panairët, të quajtura si *panagjur* (nga gr.: πανηγυρις). Panairët mesjetarë ishin kontakte midis blerësit dhe shitësit, mbledhur në një vend të caktuar me produktet e tyre në një sezon të caktuar apo në mënyrë të rregullt sidomos në ditë të veçanta - ditë festash kishtarë, të cilat ishin shtytëse të tregtisë. Edhe pse objektivi kryesor i panairëve mesjetarë ishte tregtia, që ato të bëheshin sa më të frekuentuara, veçori e çdo panairi ishin elementët e argëtimit. Ndoshta, duke filluar nga tregtarët, në përpjekje për të shitur mallrat e tyre, njerëzit ishin të vendosur për të tërhequr klientët të mallrat e tyre. Si rezultat, këto argëtime të panairëve tërhiqnin pas vetes turma njerëzish, këngëtarë, muzikantë, akrobatë etj. duke mos munguar edhe ushqimet dhe pijet e ndryshme, të cilat vireshin në dispozicion.³⁰

Të tilla panairë organizoheshin katër herë në vit në Prizren: një panair i kishës, ditën e Zojës së Vogël më 8 shtator, dy panairë të manastirit të Kryeengjëjve Mëhill dhe Gabriel,³¹ dhe një i manastirit të Hilandarit në prag të ditës së Shën Nikollës; të tjera ishin në Hoçë, Pejë, Lipjan si dhe në Graçanicë ditën e Dëftimit të Zojës së Bekuar.³²

²⁹ HR-DADU, *Acta Consilii Minoris*, vol.I (1415-1418), fol.34r; Stanoje Stanojević, *Iz naše prošlosti: slike iz kulturne istorije srednjega veka*, knj.1, (Beograd: Geca Kon, 1934), 64

³⁰ Gjon Berisha, *Arbëroret ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI-XV*, (Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri", 2015), 531.

³¹ Stojan Novaković, *Zakonski spomenici srpskih država srednjega*, (Beograd: Srpska Kraljevska Akademija, 1912), 40-641.

³² Franz Miklosich, *Monumenta Serbica: Spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii*,

Panaire për ditë festash organizoheshin edhe në viset arbërore në Maqedoninë e sotme, përkatësisht në Tetovë, Shkup, Kërçovë etj. Kështu për shembull në kohën e Stefan Uroshit II Millutinit (1282-1321), në Shkup më 8 nëntor organizohej panairi vjetor në pronat e manastirit të Shën Gjergjit, i cili zgjaste tetë ditë, ku midis të tjerëve përmendën edhe shqiptarët. Panairi i dytë organizohej më 8 shtator, në fshatin Brod. Në një panair tjetër në rrethinat e Shkupit u lejua që në kuadër të manastirit të Shën Gjergjit të shitej vetëm verë, drithë dhe mish nga pronat e këtij manastiri.³³

Në kalendarin kishtar, krahas festave kryesore si *Krishtlindjet* dhe *Pashkët* dilnin veçanërisht në pah edhe ditët e shenjtoreve.³⁴ Me këto ditë ishin të lidhura shumë veprime të jetës: ndalesa e urdhëresa të ndryshme për punën, martesën, gjykimin, mbjelljen e korrjen, kryerjen e obligimeve tatimore etj., gjë që e bënte të theksuar pozicionin e kishës dhe klerit në jetën e përditshme qytetare. Gjatë këtyre festave organizoheshin procesione, pelegrinazhe dhe karnavale të ndryshme, me pjesëmarrje të turmave të pafundme të audiencës të shoqëruara me ushqime, muzikë dhe lojëra.

Karnavalet ishin një formë tjetër e argëtimit, veçanërisht në zonat katolike, por me një traditë të lashtë pagane që nga periudha dardane. Gjatë tyre, njerëzit visheshin me kostume dhe maska duke krijuar një atmosferë feste.³⁵ Në lashtësi karnavalet përfaqësonin rizgjimin pas sezonit dimëror, vitalitetin dhe shiheshin si një shans për të larguar të keqen përmes lumturisë së momentit me festa, shaka dhe vallëzime. Ky aktivitet gjatë mesjetës, në mënyrë kalendarike, vendosej midis Epifanisë dhe Kreshmës (e Marta e Madhe, një ditë para të Mërkurës së Hirit). Një nga karnavalet më të njohura mesjetare ishte ai i Raguzës,³⁶ e cila kishte lidhje të ngjeshura tregtare, të

(Viennae: apud Guilelmum Braumüller, 1858), 562-566, dok. 439

³³ St. Novaković, *Zakonski spomenici*, 611, 615, 620.

³⁴ *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesa deri më 1469*, përgatitur nga Lucia Nadin (Tiranë: Onufri, 2002), kreu 3, 7, 50, 77, 82, 89, 113.

³⁵ Robert Elsie, *A Dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk Culture*, (London: C. Hurst & Co. Publishers, 2001), 50.

³⁶ Seraffino Razi, *Povijest Dubrovnika*, prev. Iva Grgić i Stjepan Krasić, Dubrovnik: Matica Hrvatska - Ogranak Dubrovnik, 2011, 163; Daria Nedić, Dora Rašić, "Tradicijski karneval Dubrovčana", *Essehist: časopis studenata povijesti i drugih društveno-humanističkih znanosti*, Vol. 12 No. 12, (Osijek, 2021), 3-5.

reflektuara edhe në jetën shoqërore, kulturore e kishtare të qyteteve të Kosovës.

Gjuetia e kafshëve dhe e shpezëve, po ashtu, ishte një nga format e rëndësishme të argëtimit për shoqërinë mesjetare, veçanërisht për aristokracinë. Gjuetia e kaprojve, e lepujve, e derrave të egër dhe shpezëve të egra ishte veçanërisht popullore. Ajo nuk ishte vetëm një mënyrë për të siguruar ushqim, por edhe një aktivitet shoqëror që kërkonte aftësi të larta. Kjo praktikë, e cila kryhej me ndihmën e qenëve dhe skifterëve, ishte e organizuar mirë dhe shpesh përfshinte grupime të caktuara fisnikësh dhe kalorësish që merrnin pjesë në ekspedita gjuetie.³⁷

Në aktdhuratën e përmendur të manastirit të Shën Gjergjit afër Shkupit (1300), së bashku me fshatrat e dhuruara përmenden edhe vendgjuetitë e kafshëve të egra. I njëjti akt parashikonte se kushdo që kapej në vendgjuetinë e manastirit duke gjuajtur kafshë të egra pa pyetur igumenin, detyrohej t'i dorëzonte tempullit një të katërtën e gjahut.³⁸

Argëtimet gjetën shprehje edhe në festat tradicionale shqiptare (Shëngjergji, Shënmitri, festa e të Vjelave etj.)³⁹ të cilat manifestoheshin përmes lojërave popullore, këngëve dhe valleve tradicionale, festat e shumta lokale, kuzhinës tradicionale, artizanateve të ndryshme etj.

Argëtimet mesjetare ishin një pjesë thelbësore e jetës shoqërore, pavarësisht nga statusi shoqëror i individëve, si të lirë - fisnike, ashtu edhe të fshatarësisë së varur. Nga turnetë kalorësiake dhe festat fetare e familjare, deri te lojërat popullore dhe vallëzimet, këto forma argëtimi ndihmonin njerëzit e Mesjetës të largoheshin nga vështirësitë e jetës së përditshme, duke krijuar momente të përbashkëta dhe gëzimi në komunitetet e tyre. Nga materialet e shqyrtuara del se aktivitetet sportive dhe garat e kalorësisë ishin të karakterit garues, ndërsa lojërat ishin për argëtim. Sportet që vlerësoheshin dhe praktikoheshin më shumë, ishin ato sporte, të cilat mund të përdoreshin si pjesë e arteve marciale. Praktika e tyre ishte, në të njëjtën kohë, stërvitje për

³⁷Baudouin Van den Abeele, "Medieval Hunting", *A cultural history of animals in the medieval age*, edited by Brigitte Resl, New York: Berg, 2007, 60-79.

³⁸ St. Novaković, *Zakonski spomenici*, 612-613, 617.

³⁹ Rrok Zojzi, *Gjurmët e një kalendari primitiv në popullin tonë* (Kolona "Etnografi në diktaturë"; I), Tiranë: ASA, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, 2020, 35-47.

luftë. Ndaj një pjesë e aktiviteteve sportive luftarake, përveç argëtimit, ishin edhe obligim.

Lojërat, veçanërisht ato të mëdha, bëheshin me rastin e ditëve të rëndësishme, qofshin ato festa kishtare që përsëriteshin çdo vit në kohë të caktuara (siç ishte loja e kalorësisë në Prishtinë me rastin e Krishtlindjes, ditët e festave kishtare, etj), ose ato që organizoheshin me rastin e kremtimit të disa ngjarjeve të rastit, si: lindja e fëmijës, dasma, ngjitja në fron etj.

Tubimet argëtuese në qytete lidheshin me organizimin e panairove tregtare e karnavaleve, kurse në manastire e kisha me festa fetare që mbaheshin në ditë të caktuara. Zhvillimi ekonomik i qyteteve të Kosovës gjatë shek.XIV-XV, tërhoqi shumë profesionistë të huaj, kryesisht nga bregdeti i Adriatikut, të cilët, përveç banorëve vendas, kontribuan në zhvillimin e aktiviteteve argëtuese. Nevoja për relaksim dhe argëtim nxori në shesh edhe profesionist të këtyre aktiviteteve, si: sportistë, kalorës, aktorë, muzikantë, kërcimtarë, performues të ndryshëm etj. Një pjesë e lojërave kishin një traditë nga lashtësia, kurse disa të tjera gjetën përdorim gjatë mesjetës dhe kishin ngjashmëri me vendet fqinje dhe ato perëndimore.

Vendet ku organizoheshin këto aktivitete, në të shumtën e rasteve ishin hapësirat sportive të caktuara (hipodrome), kryesisht në periferi të qyteteve (siç ishte rasti me Prishtinë dhe Novobërdën), oborret e aristokracisë, sheshet publike dhe tregjet, oborret e kishave etj. Organizimi i tyre, përveç karakterit sportiv e argëtues, sillte edhe përfitime ekonomike për organizatorët, nga shitjet e produkteve dhe konsumimi i ushqimeve dhe pijeve nga audienca. Këto performanca shërbenin jo vetëm si argëtim, por edhe për të forcuar marrëdhëniet shoqërore dhe fqinjësore. Shembujt e garave sportive dhe aktiviteteve tjera argëtuese tregojnë se jo vetëm aristokracia, por edhe popullata e zakonshme mori pjesë në këto aktivitete, një pjesë e të cilave janë bartur brez pas brezi deri në ditët e sotme.

Gjon BERISHA

SUMMARY

GAMES AND ENTERTAINMENTS DURING MEDIEVAL PERIOD IN KOSOVO

Medieval entertainments were an essential part of social life, regardless of the social status of individuals, both free - noble and dependent villagers. From jousting tournaments and religious and family celebrations, to traditional games and dances, these forms of entertainment helped the people of the Middle Ages escape from the hardships of everyday life, creating moments of togetherness and joy in their communities. From the reviewed materials, it appears that sports activities and equestrian competitions were of a competitive nature, while games were for fun. The sports that were valued and practiced the most were those sports that could be used as part of martial arts. Their practice was, at the same time, training for war. Therefore, some of the martial sports activities, in addition to entertainment, were also mandatory.

The games, especially the big ones, were held on the occasion of important days, whether they were church holidays that were repeated every year at certain times (such as the knightly game in Pristina on the occasion of Christmas, church feast days, etc.), or those which were organized on the occasion of the celebration of some special events, such as: the birth of a child, wedding, ascension to the throne, etc. Fun gatherings in cities were associated with the organization of trade fairs and carnivals, while in monasteries and churches with religious festivals held on certain days. The economic development of the cities of Kosovo during the 14th-15th centuries attracted many foreign professionals, mainly from the Adriatic coast, who, in addition to local residents, contributed to the development of entertainment activities. The need for relaxation and entertainment also brought out the professionals of these activities, such as: athletes, riders, actors, musicians, dancers, various performers, etc.